



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E MBROJTJES  
MINISTRI

UDHËZIM

Nr \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2016

PËR

**PROCEDURAT DHE KRITERET PËR REKRUTIMIN E NËNOFICERËVE  
AKTIVË NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 121, 124 dhe 125 të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, të shkronjës “f”, pikës 2, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, si dhe të pikës 4, të nenit 16, të ligjit nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”,

**UDHËZOJ:**

**KREU I**

**TË PËRGJITHSHME**

**1. Hyrje**

Në kushtet e një profesionalizmi më të lartë të FA-së dhe një angazhimi gjithnjë e më të madh në përmbushje të detyrave në mbrojtje të vendit dhe në interes të Aleancës, rekrutimi i nënoficerëve me një profil sa më cilësor është thelbësor dhe ka një ndikim të rëndësishëm mbi të ardhmen e FA-së. Një gjë e tillë mund të arrihet nëpërmjet përsosjes së sistemit të përzgjedhjes dhe instrumenteve të vlerësimit, si dhe motivimit të tyre nëpërmjet pagës dhe mundësive për karrierë.

**2. Qëllimi**

Ky udhëzim përcakton procedurat dhe kriteret që do të zbatohen nga strukturat përgjegjëse për përzgjedhjen e ushtarit/detarit IV për ndjekjen e Kursit fillestar të nënoficerit. Qëllimi kryesor është që nëpërmjet procedurave përzgjedhëse të arrihet që të rekrutohen nënoficerë me cilësi fizike dhe shëndetësore të përshtatshme dhe me një nivel të lartë moral, kulturor dhe profesional.

**3. Referencat Ligjore**

- Ligji nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

- Ligji nr. 59/2014 “Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 9210, datë 23.03.2004 “Për Statusin e Ushtarakut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

#### 4. Përkufizime

Në zbatimin e këtij udhëzimi termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim;

- a) **“Lista e meritës”** është lista e renditjes të ushtarëve/detarëve IV, të cilët marrin pjesë në konkurrim, në përfundim të testimit, sipas pikëve, duke filluar nga kandidati që ka marrë më shumë pikë.
- b) **“Titujt e meritës”** janë ata tituj të cilët, megjithëse nuk janë të detyrueshëm për t’u rekrutuar si nënoficerë, përbëjnë një vlerë të shtuar, të cilat merren në konsideratë gjatë hartimit të listës finale të meritës.
- c) **“Konkurrimi i brendshëm”** është konkurrimi i cili i rezervohet vetëm personelit brenda radhëve të FA-së dhe nuk është i hapur për publikun.

#### 5. Fusha e zbatimit

Kërkesat e këtij udhëzimi janë të detyrueshme për të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura. Strukturat përgjegjëse për zbatimin e procedurave dhe kritereve të rekrutimit të nënoficerëve janë: Shtabi i Përgjithshëm i FA-së, Komandat e Forcave/Komanda Mbështetëse, KDS-ja, Komandat e njëjësive dhe reparteve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Personeli, Drejtoria e Personelit në SHP (J1), Akademia e Nënoficerëve, Qendra e Personel-Rekrutimit dhe Spitali Ushtarak i Forcave të Armatosura.

#### 6. Objektivat

- Të sigurohet aplikimi i metodave më të mira që përdoren për rekrutimin e nënoficerëve.
- Të mundësohet rekrutimi i nënoficerëve me një profil sa më cilësor, përmes përsosjes së sistemit të përzgjedhjes dhe instrumenteve të vlerësimit;
- Të sigurohet që barazia e mundësive të konsiderohet si pjesë integrale e procedurës.
- Të ruhen standardet profesionale gjatë rekrutimit;
- Të sigurohet paanshmëri, transparencë, mosdiskriminim dhe objektivitet në procesin e përzgjedhjes.

#### 7. Strukturat, Autoritetet dhe Përgjegjësitë

7.1. Strukturat që përfshihen në procesin e rekrutimit të nënoficerëve në FA janë:

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Personelit ( DBNJZHP) në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse ( DPSHM), në Ministrinë e Mbrojtjes;
- Drejtoria e Personelit në SHP (J1);
- Drejtoria e Arsimit dhe Përkujdesjes Sociale për Ushtarakët (DAPSU);
- Qendra e Personel-Rekrutimit (QPR);
- Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes (KDS), Akademia e Nënoficerëve (ANO);
- Komandat e Forcave/Komanda Mbështetëse dhe komandat e reparteve dhe njëjësive.

a) **Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Personelit në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbime Mbështetëse përgjigjet për:**

- hartimin e politikave, procedurave dhe kritereve të rekrutimit të nënoficerëve, duke bashkëpunuar me J1-in;
- monitorimin e zbatimit të procedurave dhe kritereve gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatëve.

**b) Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA (J1) përgjigjet për:**

- hartimin e planit vjetor të rekrutimit, i cili duhet të përcaktojë numrin e personelit që do të rekrutohet, të ndarë me forca dhe specialitete;
- dërgimin e planeve të rekrutimit, pas miratimit të tyre nga SHSHP-ja, KDS-së, QPR-ja dhe Komandat e Forcave/Komandës Mbështetëse;
- kontrollin dhe zbatimin e procedurave dhe kritereve të rekrutimit të nënoficerëve;
- mbikëqyrjen e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve;
- përgatitjen e praktikave për titullimin “nënoficer” dhe gradimin “nëntetar” nga SHSHP-ja të kursantëve që propozohen nga titullari i institucionit arsimor dhe stërvitor në FA, i cili ka certifikuar kandidatin në përfundim të Kursit fillestar.
- përgatitjen e praktikave për emërimin e nëntetarëve të rinj, të cilët janë planifikuar të emërohen në SHP ose në strukturat e varësisë direkt (drejtpërdrejt);
- përgatitja e praktikave për SHSHP-në, për kalimin në emërtesë të nëntetarëve të rinj të planifikuar për t’u emëruar në forca.

**c) Qendra e Personel-Rekrutimit përgjigjet për:**

- administrimin e aplikimeve, verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së dokumenteve të aplikantëve dhe të dhënave të deklaruara, hedhjen e të dhënave në sistemin automatizuar dhe dërgimin e listës së kandidatëve, të cilët janë konsideruar të përshatshëm për konkurrim, Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes/Akademisë së Nënoficerëve;
- mbështetjen e Komisionit të testimit intelektual me sistemin e automatizuar, për vlerësimin e testit intelektual, si dhe me të dhëna të nevojshme në kuadrin e verifikimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të titujve të meritës.

**d) Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes përgjigjet për:**

- përgatitjen e testit intelektual në bashkëpunim me DAPSU-në, QPR-në dhe J1-in;
- zhvillimin e testimit sipas procedurave dhe kritereve të këtij udhëzimi;
- zhvillimin e Kursit fillestar të nënoficerit në ANO, me kandidatët të cilët janë shpallur fitues në përfundim të konkurrimit;
- me mbarimin e Kursit fillestar të nënoficerit, KDS-ja i përcjell Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, propozimet e Komandantit të ANO-së për titullim e kursantëve “*nënoficer aktiv*”.

**e) Përgjegjësitë e Komandave**

- Komandat e reparteve informojnë ushtarët/detarët IV për mundësitë që kanë për t’u rekrutuar si nënoficerë dhe përfitimet që ata kanë në rast rekrutimi, i njohin ata me kriteret që kërkohen, me mënyrën e aplikimit dhe me testimet që do të zhvillohen;
- Komandat me të marrë një kopje të kërkesës do të kontrollojnë saktësinë e të dhënave të deklaruara nga kandidati dhe do të verifikojnë plotësimin e kritereve për të marrë pjesë në konkurrim.

- në rast se komandat konstatojnë se kandidati nuk përmbush kriteret e kërkuara, atëherë njoftojnë ushtarët/detarët për mos përmbushjen e kriterëve dhe pezullojnë procedurën e dërgimit të dokumenteve të aplikimit në QPR;
- për çdo kandidat që plotëson kriteret e nevojshme, plotësojnë një formular të dhënash, sipas Aneksit B, bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij udhëzimi;
- brenda 5 ditëve nga data e aplikimit Komandat e Forcës/Komanda Mbështetëse do të përcjellin në QPR, kërkesën e aplikimit (Aneksi A) dhe formularin e të dhënave (Aneksi B), bashkëlidhur dhe pjesë e pandarë e këtij udhëzimi;
- në rast transferimi të kandidatit, të informojë komandën përkatëse për aplikimin e kandidatit për të marrë pjesë në konkurrim, e cili do të ndjekë në vijim masat për procedurën e konkurrimit të kandidatit.
- pas titullimit nënoficer dhe dhënies së gradës “nëntetar”, sipas kompetencave të përcaktuara nga ligji nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit dhe komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, komandat do të bëjnë emërimin në detyrë të nëntetarëve të rinj, të cilët me urdhër të SHSHP-së të FA-së kanë kaluar në emërtesë të tyre për emërim.
- pas emërimit, komandat do të dërgojnë në Qendrën e Personel-Rekrutimit një kopje të urdhrin të emërimit.

## **KREU II**

### **PROCEDURA DHE KRITERET E REKRUTIMIT TË NËNOFICERËVE AKTIVË**

#### **1. Të përgjithshme**

- a) sipas nenit 5, pika 5, të ligjit 59/2014, “nënoficer aktiv” është ushtaraku i titulluar si i tillë me urdhër të SHSHP-së të FA-së;
- b) rekrutimi i nënoficerëve bëhet nëpërmjet *konkurrimit të brendshëm*;
- c) në konkurrim mund të marrin pjesë vetëm ushtarët/detarët IV që plotësojnë kriteret e përcaktuara në pikën 2, të kreut II, të këtij udhëzimi;
- d) konkurrimi do të zhvillohet sipas nevojave faktike të Forcave të Armatosura dhe specialiteteve. Nevojat e rekrutimit përcaktohen nga SHSHP-ja.
- e) publikimi i njoftimit për konkurrim, mënyra e aplikimit, afatet, dokumentet që duhet të paraqesin, kriteret që duhet të plotësojnë, testimet që do të zhvillohen, si dhe informacione të tjera të dobishme do të bëhen publike për të gjithë personelin e interesuar *në faqen e internetit të SHPFA-së* dhe nëpërmjet komandave, 3 muaj para fillimit të konkurrimit;
- f) struktura përgjegjëse për zhvillimin e testimit është KDS-ja/Akademia e Nënoficerëve;
- g) aplikimi do të bëhet pranë komandave ku ushtarët/detarët IV kryejnë shërbimin, sipas formatit të kërkesës të publikuar në faqen e internetit të SHP-së;
- h) konkurrimi nuk është i hapur ndaj publikut jashtë FA-së.
- i) kandidatët, që do të aplikojnë pas skadimit të afatit të bërë publik, nuk do të pranohen për të marrë pjesë në konkurrim;
- j) pozicionet organike të cilat në TOP janë cilësuar për meshkuj do t’u ofrohen vetëm meshkujve, ndërsa pozicionet e tjera janë të hapura për meshkuj dhe femra.
- k) preferohen kandidatët që kanë arsim të lartë dhe njohuri në gjuhët e huaja.

#### **2. Kriteret e konkurrimit për të ndjekur kursin fillestar të nënoficerit**

2.1. Ushtari/Detari IV për të ndjekur Kursin fillestar të nënoficerit duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

- a) në momentin e aplikimit, të ketë jo më pak se dy vjet si ushtar/detar IV;
- b) në momentin e aplikimit të mos jetë më shumë se 32 vjeç;
- c) të jetë vlerësuar jo më pak se “shumë mirë” ose “mbi mesatar” në dy vlerësimet e fundit vjetore, vlerësimet i referohen vlerësimit të eprorit më të lartë;
- d) të ketë kryer arsimin parauniversitar;
- e) të jetë vlerësuar kalues në testin e përgatitjes fizike;
- f) të jetë i aftë nga ana shëndetësore;
- g) të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 165 cm për meshkujt dhe 160 cm për femrat.

2.2. Kriteret e përshkruara më lart duhet të plotësohen dhe mbahen deri në datën e fillimit të Kursit Fillestar të Nënoficerit, në të kundërt, kandidati ndërpret konkurrimin ose kursin.

### 3. Aplikimi

- a) kërkesa për të marrë pjesë në konkurrim i adresohet komandës së repartit ku ushtari/detari IV është duke kryer shërbimin;
- b) kërkesa do të bëhet sipas formatit dhe modaliteteve të trajtuara në Aneksin A, brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së publikimit në faqen e internetit të SHP-së, në adresën [www.aaf.mil.al](http://www.aaf.mil.al);
- c) së bashku me kërkesën, aplikanti duhet të paraqesë edhe raportin e ekzaminimeve mjekësore.

### 4. Komunikimi me kandidatët

Pas aplikimit, komunikimi me kandidatët do të mbahet nëpërmjet publikimit të njoftimeve në faqen e internetit të SHP-së dhe nëpërmjet komandave përkatëse. Komunikimet me karakter kolektiv do të publikohen në faqen e internetit të SHP-së, ndërsa ato me karakter personal do të bëhen të ditura nëpërmjet komandave. Këto komunikime kanë karakter njoftimi me të gjitha efektet.

### 5. Zhvillimi i konkurrimit

5.1. Zhvillimi i konkurrimit përfshin:

- a) testimin intelektual;
- b) testimin fizik;
- c) ekzaminimin mjekësor;
- d) testimin e njohurive në njohjen e gjuhës angleze;
- e) testimin psikologjik;
- f) vlerësimin e titujve të meritës.

5.2. Çdo kandidat do t'i nënshtrohet testit sipas shkronjave “a”, “b” dhe “e” në harkun kohor të një dite. Testimi i shkronjës “d” nuk është i detyrueshëm, por aftësitë në këtë fushë përbëjnë titull merite dhe vlerësohen me pikë. Kandidatët që nuk marrin pjesë në testimin e shkronjës “d” do të vlerësohen me “0” pikë;

5.3. Testimet do të zhvillohet pranë Akademisë së Nënoficerëve, e cila është struktura përgjegjëse për marrjen e masave organizative dhe mbarëvajtjen e procesit të testimit;

5.4. Njoftimi i kandidatëve për datën dhe mënyrën e zhvillimit të testeve, si dhe rregullat e menaxhimit të procesit përcaktohen nga J1-shi, të cilat përveçse bën publike në faqen e

internetit të SHP-së, njofton edhe komandat përkatëse, me qëllim që të marrin masat e nevojshme.

## **6. Komisionet e testimit dhe përbërja e tyre**

6.1. Për vlerësimin e kandidatëve gjatë zhvillimit të testeve caktohen *komisionet* e mëposhtme:

- Komisioni mjekësor;
- Komisioni për vlerësimin e testimit fizik;
- Komisioni për vlerësimin e testimit intelektual;
- Komisioni për vlerësimin e testimit psikologjik;
- Komisioni për vlerësimin e njohurive të gjuhës angleze.

### *6.2. Përbërja e komisioneve*

a) *Komisioni për vlerësimin e testimit intelektual* përbëhet nga:

- një oficer me gradën kolonel, përfaqësues i KDS-së, kryetar;
- një oficer me gradën nënkolonel, përfaqësues i J3 në SHPFA, anëtar;
- një oficer me gradën major ose nënkolonel përfaqësues i ANO-së, anëtar;
- një nënoficer me gradën kapter, përfaqësues i ANO-së, anëtar;
- një oficer me gradë major ose nënkolonel, përfaqësues i QPR-së, anëtar;
- një oficer me gradë të ulët, përfaqësues i ANO-së, sekretar.

*Ai ka për detyrë:*

- të mbikëqyrë zhvillimin e testeve;
- të vlerësojë testin intelektual, të administrojë rezultatet e testimit të përgatitjes fizike, të testimit psikologjik dhe të vlerësojë titujt e meritës;
- të hartojë listën finale të meritës dhe t'ia përcjellë Drejtorisë së Personelit në SHPFA (J1), së bashku me relacionin përkatës.

b) *Komisioni i testimit fizik* përbëhet nga:

- një oficer me gradën nënkolonel, përfaqësues i J3-it në SHP, kryetar;
- dy oficerë ose civilë, instruktorë të përgatitjes fizike, përfaqësues të KDS-së, anëtar;
- dy nënoficerë nga trupa e nënoficerëve, përfaqësues të ANO-së dhe QPR-së, anëtar;
- një oficer me gradë të ulët, përfaqësues i ANO-së, sekretar.

c) *Komisioni i testimit psikologjik* përbëhet nga:

- një oficer me gradën nënkolonel, përfaqësues i KDS-së, kryetar;
- një oficer me gradën kapiten, specialist në fushën e psikologjisë, përfaqësues i QPR-së, anëtar;
- një nëpunës civil, përfaqësues i DAPSU-së, i kualifikuar në fushën e psikologjisë, anëtar;
- një nënoficer me gradën kapter, përfaqësues i ANO-së, sekretar.

d) *Komisionet e testimit të gjuhës angleze dhe ekzaminimit mjekësor* përcaktohen respektivisht nga QGJH-ja dhe SPUFA-ja.

6.3. Komisionet e vlerësimit miratohen nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm sipas propozimeve të paraqitura nga J1-shi.

## 7. Ekzaminimi mjekësor

- a) ekzaminimi mjekësor i kandidatëve kryhet nga Spitali Ushtarak i Forcave të Armatosura. Ai do të kryhet përpara aplikimit dhe është parakusht për të marrë pjesë në konkurrim;
- b) ekzaminimi mjekësor zhvillohet sipas procedurave dhe standardeve të përcaktuara për këtë qëllim dhe përfshin: vizitë tek patologu, okulisti, kardiologu, neurologu/ psikiatri, kirurgu, ORL dhe analizat AgHbs, HIV test, grupi i gjaku/Rezus;
- c) në përfundim të ekzaminimeve mjekësore, komisioni mjekësor vendos nëse kandidati është i aftë për të shërbyer në Forcat e Armatosura ose jo;
- d) vendimi i komisionit të ekzaminimit mjekësor dorëzohet nga kandidati gjatë fazës së aplikimit.

## 8. Testimi fizik

- a) testimi fizik është *hapi i parë* i konkurrimin dhe ka si qëllim të verifikojë standardet fizike që kandidatët duhet të plotësojnë;
- b) kontrolli i aftësive fizike zhvillohet sipas procedurave dhe normave të përcaktuara në Rregulloren e Testit Ushtarak të Përgatitjes Fizike, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, nr. 1947, datë 7.11.2013;
- c) kandidati, duhet të arrijë minimumi 60 pikë për çdo disiplinë të përgatitjes fizike, për të vijuar konkurrimin e mëtejshëm. Kur kandidati nuk arrin të sigurojë 60 pikë për çdo disiplinë, ndërpret konkurrimin e mëtejshëm;
- d) në testimin fizik kandidati duhet të paraqitet me veshje sportive (bluzë e pantallona të shkurtra/tuta) dhe këpucë sportive (atlete), në të kundërt nuk do të lejohen që të marrin pjesë në testim;
- e) për kandidatët që nuk paraqiten me veshje sportive gjatë testit fizik njoftohen komandat për aplikimin e masave disiplinore ndaj tyre;
- f) kandidatët do të testohen fizikisht, pavarësisht nga rezultatet që kanë marrë në testin fizik të zhvilluar pranë komandave të tyre;
- g) në përfundim të testimit fizik, komisioni i vlerësimit përgatit *listën e meritës*, duke filluar rreshtimin nga kandidati që ka marrë më shumë pikë në provat e zhvilluara dhe ia përcjellë atë Komisionit të testimit intelektual, me shkrim dhe në format elektronik.

## 9. Testimi i intelektual

- a) nëpërmjet testimit intelektual, synohet të vlerësohet niveli i njohurive dhe kulturës së përgjithshme dhe niveli i njohurive bazë ushtarake, aftësitë për të gjykuar dhe për të vepruar, aftësitë e përqendrimit të vëmendjes, si dhe niveli i përgjithshëm i inteligjencës;
- b) testimi intelektual zhvillohet pas kualifikimit në testin e përgatitjes fizike. Ai zhvillohet në mënyrë elektronike dhe përbëhet nga dy pjesë:
  - nga testi i përgjithshëm intelektual i cili zë 40% të testit intelektual dhe;
  - nga testi i njohurive ushtarake i cili zë 60% të testit intelektual.
- c) testi i përgjithshëm intelektual përbëhet nga:
  - *testimi i njohurive në shkencat e përgjithshme*, i cili ka si qëllim të testojë njohuritë në fushat: histori, gjeografi, fizikë, kimi, letërsi, arsyetim aritmetik dhe njohuri matematikore. Ky test ka 30 pikë dhe zë 20% të pikëve të testit intelektual;
  - *testimi për njohjen e kuptimitin e fjalëve, shprehjeve dhe paragrafëve*, i cili shërben për të përcaktuar aftësitë e kandidatit në zgjedhjen dhe kuptimin e saktë të fjalëve dhe

shprehjeve të përdorura në fjali apo për të përcaktuar thelbin e informacionit nga paragrafët e shkruar. Ky test ka 30 pikë dhe zë 20% të pikëve të testit intelektual;

- d) Testi i njohurive ushtarake përbëhet nga:
- *testimi i njohurive bazë ushtarake*, i cili shërben për vlerësimin e nivelit të dijeve bazë ushtarake. Ky test ka 70 pikë dhe përbën 45% të pikëve të testit intelektual. Fushat e testimit janë: përgatitje taktike, përgatitje zjarri, përgatitje rreshtore dhe lidershipi;
  - *testimi i njohurive bazë të specialitetit*, i cili shërben për të vlerësuar nivelin e dijeve dhe integritetin e kandidatëve në specialitetin përkatës. Testi zhvillohet në fushat: xhenio, kimi, topografi, shëndetësi, ligjshmëri, zbulim, rregullore ushtarake etj. Ky test ka 25 pikë dhe zë 15% të pikëve të testit intelektual.
- e) në testin intelektual minimumi i pikëve për kualifikim do të jetë 78 pikë nga 155 të mundshme. Kandidati që nuk arrin minimumin e pikëve skualifikohet, duke ndërprerë konkurrimin e mëtejshëm. Kontrolli dhe rezultati i testit intelektual bëhet nëpërmjet sistemit elektronik. Renditja bëhet duke filluar nga kandidati që ka marrë pikët maksimale dhe vijon në rendin zbritës deri tek kandidati që ka marrë më pak pikë;
- f) testi intelektual përgatitet nga KDS-ja/ANO-ja në bashkëpunim me QPR-në. Ai përgatitet në disa variante dhe përditësohet sa herë që një gjë e tillë është e nevojshme. Testi administrohet nga QPR-ja.

## 10. Testimi psikologjik

- a) testimi psikologjik është hapi i tretë i konkurrimit dhe zhvillohet me qëllim që të vlerësohen tek kandidati përgjegjshmëria, motivimi, aftësia për të menduar dhe për të gjykuar, si dhe stabiliteti i sjelljes;
- b) testimi psikologjik zhvillohet pas testimit të kulturës së përgjithshme dhe kulturës ushtarake;
- c) testimi psikologjik zhvillohet në formë interviste dhe është skualifikues. Në çdo rast, arsyet e skualifikimit të kandidatëve motivohen me shkrim;
- d) në përfundim të testimit psikologjik, komisioni përkatës i përcjell komisionit të kulturës së përgjithshme dhe kulturës ushtarake, me shkrim dhe në format elektronik, listën e kandidatët që janë vlerësuar të përshtatshëm për vijimin e mëtejshëm të konkurrimit.

## 11. Testimi në gjuhën angleze

- a) testimi në gjuhën angleze është hapi i katërt i konkurrimit dhe do të bëhet me qëllim që të verifikohet niveli i njohjes së gjuhës angleze të pjesëmarrësve në konkurrim. Ky konkurrim nuk është i detyrueshëm, por aftësitë në këtë fushë përbëjnë titull merite dhe vlerësohen me pikë, siç përcaktohet në pikës 12 “vlerësimi i titujve të meritës”, shkronja “d”. Kandidatët që nuk marrin pjesë në testim do të vlerësohen me “0” pikë;
- b) KDS-ja/QGJH-ja është përgjegjëse për zhvillimin e testimit të gjuhës angleze;
- c) testimi i gjuhës angleze do të bëhet sipas ALCPT-së;
- d) në përfundim të testimit, QGJH-ja i paraqet komisionit të vlerësimit të kulturës së përgjithshme dhe kulturës ushtarake rezultatet e testimit të gjuhës angleze, me shkrim dhe në mënyrë elektronike.

## 12. Vlerësimi i titujve të meritës



- a) titujt e meritës janë ato tituj të cilët, megjithëse nuk janë të detyrueshëm për rekrutimin, përbëjnë një vlerë të shtuar, të cilat merren parasysh gjatë hartimit të listës finale të meritës;
- b) Komisioni i vlerësimit me qëllim formimin e listës finale të meritës do të vlerësojë edhe titujt e meritës, vetëm për kandidatët të cilët janë vlerësuar të përshtatshëm, në përfundim të testimit psikologjik. Vlerësimi i titujve të meritës është hapi i fundit i konkurrimit dhe do të përfundojë dy ditë pas përfundimit të testimeve;
- c) në titujt e meritës do të përfshihen: *vlerësimi vjetor i punës, titujt e studimit, njohuritë në gjuhët e huaja, pjesëmarrja në operacione jashtë, dekorata dhe medaljet, masat disiplinore etj.*;
- d) maksimumi i pikëve të siguruara nga vlerësimi i titujve të meritës është 30 pikë.

Vlerësimi i titujve të meritës do të bëhet si më poshtë:

1. *Raporti i vlerësimit vjetor të punës* do të vlerësohet, maksimumi me 10 pikë:
  - vlerësimi “*i shkëlqyer*” do të vlerësohet me 10 pikë;
  - vlerësimi “*shumë mirë*” ose “*mbi mesatar*” do të vlerësohet me 8 pikë.

Llogaritja e pikëve do të bëhet sipas formulës:

$$VV=[VV1+VV2]/2$$

VV- mesatarja e vlerësimit vjetor të dy viteve të fundit;

VV1-vlerësimi vjetor i vitit parë;

VV2-vlerësimi vjetor i vitit dytë.

- 2 *Titujt e studimit do të vlerësohen në bazë të llojit të diplomës*
  - diploma e shkollës së lartë *master* (cikli i dytë i studimeve universitare) do të vlerësohet me 6 pikë;
  - diploma *bachelor* (cikli i parë i studimeve universitare) do të vlerësohet me 4 pikë;
  - diploma e *shkollës mesme profesionale* do të vlerësohet me 2 pikë.
3. *Gjuha angleze* do të vlerësohet në bazë të nivelit të njohjes së saj. Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:
  - 91-100, 5 pikë
  - 86-90, 4.5 pikë
  - 81-85, 4 pikë
  - 76-80, 3.5 pikë
  - 71-76, 3 pikë
  - 66-70, 2.5 pikë
  - 61-65, 2 pikë
  - 56-60, 1.5 pikë
  - 51-55, 1 pikë
  - 46-50, 0.5 pikë
4. *Pjesëmarrja në operacione jashtë* vendit do të vlerësohet me 5 pikë.
5. *Dekoratat/Medaljet do të vlerësohen si më poshtë:*
  - çdo dekoratë e marrë do të vlerësohet me 2 pikë;
  - çdo medalje e marrë do të vlerësohet me 1.5 pikë.
6. *Masat disiplinore që janë dhënë ndaj ushtarëve gjatë dy viteve të fundit në shërbimin aktiv do vlerësohen me pikë negative.*

- Masat disiplinore *shumë të rënda* do të vlerësohet me -3 pikë;
- Masat *e rënda* disiplinore do të vlerësohet me -2 pikë;
- Masat *e lehta* disiplinore do të vlerësohet me -1 pikë.

### 13. Lista finale e meritës

- a) Komisioni i vlerësimit të testimit intelektual do të hartojë *listën finale të meritës*, duke marrë për bazë pikët e marra nga çdo konkurrent: *në testin fizik, testin intelektual dhe në vlerësimin e titujve të meritës*
- b) sasia e pikëve finale do të llogaritet sipas formulës:

$$VF = VTUPF + VTI + VTM$$

VF- sasia totale e pikëve të siguruara nga vlerësimi i testeve të zhvilluara;

VTUPF- vlerësimi i testit ushtarak të përgatitjes fizike;

VTI- vlerësimi i testit intelektual;

VTM- vlerësimi i titujve të meritës.

- c) do të deklarohen fitues, kandidatët që përfshihen brenda kuotave të rekrutimit. Rreshtimi i fituesve do të bëhet duke filluar nga kandidati që ka marrë më shumë pikë dhe duke vijuar në rendin zbritës;
- d) në rast se ka kandidatë që kanë pikë të njëjta me kandidatin që mbyll numrin e kuotave të përcaktuara, përzgjedhja e tyre do të bëhet sipas datës së gradimit, datëlindjes dhe rendit alfabetik;
- e) lista finale e meritës firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit të vlerësimit të testimit intelektual dhe nga Kryetari;
- f) pas firmosjes, Kryetari i komisionit të vlerësimit ia përcjellë listën finale të meritës, nëpërmjet KDS-së, Drejtorisë së Personelit në SHP, me shkrim dhe në formatin elektronik.
- g) lista finale e meritës dhe nominimi i fituesve, nëpërmjet J1-shi, i paraqitet për miratim SHSHP-së të FA-së, e cila pas miratimit do të publikohet në faqen elektronike të SHP-së dhe do t'i dërgohet Komandave të Forcave/Mbështetëse/Strukturave autonome dhe KDS-së, e cila programon zhvillimin e Kursit fillestar të nënoficerit.

### 14. Ankimi

- a) kandidatët kanë të drejtë që, brenda 5 ditëve nga shpallja e rezultateve, të ankohen me shkrim pranë J1-it, për vlerësimin që iu është bërë në testet e zhvilluara;
- b) shqyrtimi i ankesave do të bëhet nga një komision i posaçëm, i ngritur nga SHSHP-ja dhe përbëhet nga:
  - një oficer me gradën nënkolonel, përfaqësues i J1, kryetar;
  - një oficer me gradën nënkolonel, përfaqësues i KDS-së, anëtar;
  - një oficer me gradën major/nënkolonel, përfaqësues i ANO-së, anëtar;
  - një nënoficer i ANO-së me gradën kapter, sekretar.
- c) kur komisioni konstaton se ankesa është e bazuar e ndryshon objektivisht ose lë në fuqi vlerësimin e komisionit, duke përditësuar listën finale të meritës.
- d) pas konsiderimit të ankesave, bëhet shpallja e rezultateve përfundimtare dhe përcaktohen kandidatët që kanë fituar të drejtën e ndjekjes së Kursit Fillestar të Nënoficerit.

### 15. Procedurat e titullimit "nënoficer aktiv" dhe gradimit "nëntetar"

- a) pas certifikimit të kursantit në përfundim të Kursit Fillestar të Nënoficerit bëhet titullimi i tyre “nënoficer aktiv”. Titullimi bëhet me urdhër të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, sipas propozimit të Komandantit të KDS-së/ANO-së, i cili ka certifikuar kandidatin në përfundim të Kursit Fillestar të Nënoficerit;
- b) në përfundim të kursit, Komandanti i ANO-së, i përcjell SHSHP-së, nëpërmjet Komandantit të KDS-së, propozimin për titullimin e kursantëve;
- c) Drejtoria e Personelit në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së, bazuar në propozimin e Komandantit të KDS-së/ANO-së, përgatit praktikën për Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, për titullimin “nënoficer aktiv” dhe gradimin “nëntetar”;
- d) Drejtoria e Personelit në SHP (J1), pas titullimit dhe gradimit të kursantëve nga SHSHP-ja, përgatit urdhrat për kalimin e nëntetarëve të rinj në emërtesë të komandave për emërimin në detyrë, ndërsa për ata që janë planifikuar të emërohen në strukturat e varësisë së SHP-së të FA-së përgatit praktikën për emërimin e tyre nga SHSHP-ja. Një kopje e urdhrave të emërimit në detyrë do të dërgohet për evidentim në QPR;
- e) në qoftë se kursanti nuk certifikohet në përfundim të kursit fillestar të nënoficerit, ai rikthehet në repartin ku kryente shërbimin përpara se të fillonte kursin përkatës.

## **16. Lidhja e kontratës**

- a) lidhja e kontratës midis nënoficerit dhe Forcave të Armatosura do të bëhet sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 9, të ligjit 59/2014 dhe Udhëzimit të Ministrit të Mbrojtjes, nr. 13 datë, 8.10.2014 “Për procedurat e lidhjes së kontratës së shërbimit ushtarak”.

### **KREU III DISPOZITA TE FUNDIT**

1. Udhëzimi Nr. 15, datë 17.01.2014 “Për procedurat dhe kriteret për rekrutimin e nënoficerëve aktivë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, shfuqizohet.
2. Përgjigjen për zbatimin e këtij udhëzimi: Komandantët e Forcave, Komandanti i Komandës Mbështetëse, Komandanti i Komandës së Doktrinae dhe Stërvitjes, Komandantët e reparteve të varësisë së drejtpërdrejtë, Qendra e Personel-Rekrutimit, drejtoritë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së.
3. Ndjek zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**

**MIMI KODHELI**